



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 shtator 2023
Nr. ref.:RK 2260/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI14/23

Parashtrues

Skender Kolgeci

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ.nr.68/2022] të 28 shtatorit
2022 të Gjykatës Supreme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Skender Kolgeci nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [ARJ.nr.68/2022] të 28 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22(Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
5. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

6. Më 27 janar 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 1 shkurt 2023 Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 6 shkurt 2023, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Remzie Istrefi Peci (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci, anëtarë.
9. Më 31 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës ishte punëtor i Komunës së Prishtinës – Drejtorisë për Urbanizëm Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit (në tekstin e mëtejshëm: DUNMM- Komuna e Prishtinës) në pozitën Zyrtar i lartë për planifikim ekonomik.

11. Më 23 shtator 2011, parashtruesi i kërkesës përmes Vendimit [nr.04-V-195] të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ishte emëruar kryesues në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime (në tekstin e mëtejme: BPR) me mandat 2 (dy) vjeçar, i cili mandat i ishte vazhduar me 24 shtator 2013 deri më 31 dhjetor 2014, ndërsa dorëzimin e detyrës së caktuar e kishte bërë më 30 janar 2015.
12. Më 2 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës përmes njoftimit [nr.05-119-26134] drejtuar Drejtorit të DUNMM në Komunën e Prishtinës, e kishte njoftuar këtë të fundit për përfundimin e mandatit të kryesuesit të Bordit, dhe kthimin e tij në vendin e tij të punës në Komunën e Prishtinës.
13. Më 2 shkurt 2015, Drejtori i DUNMM, kishte përgatitë një raport [nr.01-116-2615] për shkelje disiplinore, përmes të cilit ishte kërkuar që ndaj parashtruesit të kërkesës të merren masa disiplinore. Në raportin e Drejtorit ndër të tjera pretendohet se “ ... i lartpërmenduri ka bërë shkelje të rëndë disiplinore për shkak se i njëjti nuk është paraqitur në vendin e punës për më shumë se tre vjet. Në këtë raport është konstatuar që Skenderi nuk figuron në listën e pagave si edhe punëtorët tjerë, por me rrogë në shumë prej 0.00 euro. Me datë 23 shkurt është kontaktuar Skenderi, por nuk ka pranuar që të vij në seancë dëgjimore. Ai është kontaktuar edhe nëpërmjet bashkëshortes së tij, e cila po ashtu ka refuzuar të pranoi fletëhirrjen. Duke mos ardhur në punë, Skenderi jo vetëm që ka tejkaluar shfrytëzimin e lejuar të pushimit ujetor dhe mjekësor, por ai edhe një pjesë të madhe të mungesës në punë përgjatë gjithë kohës e ka kërkuar të paarsyetuar. Më veprimet e tij, ai e ka lënë të zbrazët një vend pune që i është caktuar. Ky veprim, medoemos ka shkaktuar dëm brenda kësaj drejtorie duke kërkuar angazhim të shtuar për të gjetur një zëvendësim për zbrazëtinë e krijuar”.
14. Më 5 shkurt 2015, Njësia e personelit – Drejtori i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Prishtinës kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij në Komisionin Disiplinor të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejme: Komisioni Disiplinor).
15. Më 2 mars 2015, Komisioni Disiplinor përmes vendimit [Nr.116-26151] gjeti përgjegjës parashtruesin e kërkesës “ sepse me fajin e vetë ka bërë shkelje të detyrave të punës në atë mënyrë që gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka bërë shkelje të rëndë – serioze të detyrave të punës, duke kryer aktivitete që bien ndesh me interesat e institucionit apo veprimet që e dëmtojnë institucionin dhe organet tjera shtetërore, shkelje të detyrave të punës që kanë pasoja për palën dhe organin shtetëror, mos ofrim i ndihmës profesionale në kuadër të kompetencave dhe detyrave të punës nëpunësve civilë, gjatë realizimit të drejtave të tyre ligjore dhe mungesa të pa arsyeshme për më shumë se dy ditë punë të njëpasnjëshme”.
16. Më 3 prill 2015, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Zgjedhje të Kontesteve në Komunën e Prishtinës kundër vendimit të Komisionit Disiplinor, me pretendimin se vendimi i kundërshtuar është plotësisht i pabazë dhe jo i ligjshëm për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës administrative, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 29 prill 2015, Komisioni për Zgjidhje të Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Prishtinës përmes Vendimit [Nr.01.007-75860] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.
18. Më 2 qershor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK) kundër Vendimit të Komisionit për Zgjidhje të Kontesteve dhe të

- Ankesave në Komunën e Prishtinës, me pretendimin se vendimi i kundërshtuar është i pabazë dhe jo i ligjshëm, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës administrative, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa dhe të anulohet Vendimi i kundërshtuar dhe të merret vendim i formës së prerë përmes të cilit ai të kthehet në pozitën e mëparshme me të gjitha të drejtat ligjore.
19. Më 22 korrik 2015, KPMSHCK përmes vendimit [A 02/283/2015] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe la në fuqi Vendimin [Nr.01.007-75860] të 29 prillit 2015 të Komisionit për Zgjidhje të Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Prishtinës.
 20. Në një datë të pasaktësuar parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi për konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) kundër vendimit [A 02/283/2015] të KPMSHCK-së.
 21. Më 10 maj 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.1536/2015] aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi vendimin [A 02/283/2015] të KPMSHCK-së të 22 korrikut 2015, dhe çështjen e ktheu në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
 22. Në një datë të pasaktësuar, KPMSHCK paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, përmes të cilës ankesë kontestoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të procedurës administrative dhe kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
 23. Më 22 tetor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.327/2019] miratoi si të bazuar ankesën e KPMSHCK-së ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore [A.nr.1536/2015] të 10 majit 2018 e anuloi dhe lëndën e ktheu në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.
 24. Më 16 qershor 2020, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.2579/2019] ne procedurë të rigjykimit, aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Vendimin [A 02/283/2015] të KPMSHCK-së të 22 korrikut 2015, dhe çështjen e ktheu në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
 25. Në një datë të pasaktësuar, pala e interesuar Komuna e Prishtinës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [A.nr.2579/2019] të 16 qershorit 2020 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që gjykata e shkallës së dytë të aprovojë ankesën të bazuar dhe të refuzojë padinë e parashtruesit të kërkesës si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin [A 02/283/2015] të KPMSHCK-së të 22 korrikut 2015, ose lëndën ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
 26. Më 18 maj 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.474/2020] aprovoi si të bazuar ankesën e Komunës së Prishtinës dhe ndryshoi aktgjykimin [A.nr.2579/2019] të 16 qershorit 2020 të Gjykatës Themelore, duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pa bazuar.
 27. Më 4 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së nenit 89 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, me propozimin që Gjykata Supreme të nxjerr aktgjykim dhe të aprovohet

padia si e bazuar dhe të anulohet vendimi [A 02/283/2015] i KPMSHCK-së i 22 korrikut 2015, ose lëndën të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

28. Më 28 shtator 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.nr.68/2022] refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [ARJ.nr.68/2022] e 28 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Pretendimet lidhur me shkeljen e neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

30. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon shkelje të neni 31 të Kushtetutës, pasi që atij i është marrë detyra e funksionarit publik, ku siç thekson ai “ *theksojmë se fakti se Komuna e Prishtinës e ka ditur se parashtruesi i kërkesës ka qenë i transferuar përkohësisht në një vend tjetër të punës e dëshmon edhe fakti se ky i fundit në listën e pagave të Komunës ka qenë i evidentuar me vlerë 0.00. Andaj nëse nga vetë punëdhënësi, respektivisht Komuna e Prishtinës është evidentuar në listën e pagave me pagë prej 0.00 euro, atëherë rezulton se Komuna ka qenë në dijeni për transferimin e përkohshëm të parashtruesit të kërkesës, sepse po sikur të mos kishte qenë në dijeni të një fakti të tillë, të njëjtin do ta largonte nga lista e pagave në tërësi”. Sipas parashtruesit të kërkesës, shtrembërimi i fakteve nga ana e Komunës në raport me parashtruesin e kërkesës, duke pretenduar kinse ky i fundit nuk e ka njoftuar Komunën se është transferuar përkohësisht në një vend tjetër pune të cilin ia garanton ligji, përbënë shkelje të ligjit.*
31. Tutje parashtruesi i kërkesës thekson se arsyetimi i vendimit të Komunës së Prishtinës, ashtu edhe vendimet pasuese si ai i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, vendimi i KPMSHCK-së, vendimi i Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme janë të kundërligjshëm dhe jo logjikë, pasi që siç thekson ai Komuna e Prishtinës ka pasur mundësi që veprimet e ndërmarra në periudhën shkurt-mars 2015, ti kishte ndërmarrë në kohën kur është kryer shkelja e pretenduar, mirëpo me vetë faktin që Komuna e Prishtinës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me inicimin e procedurës disiplinore ndaj tij në kohën kur ai është emëruar në Bordin për rishqyrtimin e ankesave tatimore dhe doganore, vërtetohet se shkelja e pretenduar nga Komuna e Prishtinës nuk është kryer nga ai.
32. Përkritazi me shkeljet e pretenduara të neni 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, në esencë, thekson se pavarësisht se me ligj është e lejuar ngrirja e pozitës, në rast të zgjedhjes në ndonjë bord të caktuar, ndaj tij janë marrë masa disiplinore për shkak të mos paraqitjes në punë në Komunën e Prishtinës. Pra parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë faktet dhe provat të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit, pasi që “ *...është shkelur neni 89 i Ligjit për Shërbyesit Civil, i cili garanton kthimin në vendin e punës personit i cili është transferuar përkohësisht, duke pasur parasysh se një e drejtë e tillë është e garantuar me ligj. Kësisoj Gjykata Supreme ka bërë shkelje të Kushtetutës përkatësisht të neni 31, duke mos arsyetuar se cilat kanë qenë shkaqet të cilat kanë dërguar deri në marrjen e aktgjykimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës, konsideron se bazuar në parimet e administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e*

gjykatave duhet të tregojnë në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat ato bazohen në momentin e nxjerrjes së një aktgjykimi, e që aktgjykimi i kontestuar Gjykata Supreme, nuk e ka marrë fare mundin që të arsyetojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës”.

33. Parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se procedura disiplinore iniciohet vetëm në rastet kur është e paraparë me ligj ose me rregullore disiplinore, dhe se iniciimi i procedurës disiplinore ndaj tij mbas 3 viteve nuk është e paraparë me ligj dhe as me rregullore disiplinore. Lidhur me këtë parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk e ka përmendur një gjë të tillë në aktgjykimin e saj, dhe si rrjedhojë ka nxjerrë aktgjykim të pabazuar, dhe me këtë atij i është shkelë e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Sipas parashtruesit, edhe në praktiken e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, është theksuar se e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit]

34. Lidhur me pretendim për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se “*Gjykata Supreme e favorizoi padrejtësisht palën kundërshtare në dëm të parashtruesit të kërkesës, gjë kjo e cila përbën shkelje të së drejtës për barazi para ligjit, të mbrojtur me nenin 24 të Kushtetutës, pasi që edhe pse i janë ofruar prova të njaftueshme Gjykatës Supreme për të vendosur në mënyrë të drejtë, kjo e fundit nuk i ka marrë fare parasysh duke nxjerrë një aktgjykim me të cilin i ka shkelur të drejtat kushtetuese”.*

Pretendimet lidhur me shkeljen e neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “*... si në Gjykatën Supreme ashtu edhe në Gjykatat e instancave më të ulëta, ka paraqitur provat në të cilat i ka mbështetur kërkesat e tij. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë shumë të qartë kishte theksuar se fakti që Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Komuna e Prishtinës, e ka vendosur atë në evidencën e pagave me 0.00 euro, nënkupton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka ndërprerë marrëdhënien e punës, por i njëjti vetëm nuk ka marrë pagë nga Komuna e Prishtinës, pasi që përkohësisht parashtruesi i kërkesës është transferuar në një vend tjetër pune brenda Kosovës, ku në institucionin në të cilin është transferuar ka marrë pagë të plotë. Nga ky fakt vërehet se parashtruesi i kërkesës dhe Komuna e Prishtinës, janë dakorduar që ai pas përfundimit të mandatit të kthehet në vendin e punës në Komunë”.* Sipas parashtruesit të kërkesës ky fakt nuk është marrë për bazë nga Gjykata Supreme, dhe se përmes këtij aktgjykimi i janë shkelë të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës.
36. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 24, 31 dhe 49 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së; dhe (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [ARJ.nr.68/2022] të 28 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme, dhe të njëjtin ta kthejë pranë kësaj gjykate në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

[...]

Neni 49

[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

LIGJI Nr. 03/L-149 PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 89

Pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil

1. Për qëllime të këtij ligji, rastet në vijim konsiderohen pezullim i dakorduar nga shërbimi civil:

1.1. pushimi pa pagesë;

1.2. transferimi i përkohshëm në detyra të tjera brenda ose jashtë Kosovës;

1.3. marrjes së detyrës së funksionarit publik;

1.4. kryerja e obligimeve ushtarake.

2. Pas mbarimit të kushtit të pezullimit të dakorduar, nëpunësi civil ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme ose në një pozitë ekuivalente.

RREGULLORE Nr. 06/2011 PËR PUSHIMET E NËPUNËSVE CIVILË

Neni 15

Pushimi pa pagesë

1. Pushimi pa pagesë mund të autorizohet në raste të veçanta nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit punëdhënës, si në vijim:

1.1. Për ngritjen profesionale për nevojat e vetë nëpunësit civil.

1.2. Për kujdesin ndaj anëtarëve të ngushtë të familjes, për shkak të sëmundjes (bashkëshortit, bashkëshortes, prindit, fëmijës, motrës, vëllait);

1.3. Për kandidim për zgjedhjet komunale dhe qendrore;

1.4. Për transferim të përkohshëm në detyra të tjera brenda ose jashtë Kosovës;

1.5. Për marrjen e detyrës së funksionarit publik dhe 1.6. Për kryerjen e obligimeve ushtarake.

2. Pas kalimit të periudhës së pushimit pa pagesë, nëpunësi civil e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme apo ekuivalente me të.

Neni 16

Procedurat e pushimit pa pagesë

1. Kërkesa për pushim pa pagesë bëhet më shkrim, si dhe përmban qëllimin dhe periudhën e pushimit.

2. Kërkesa, pas rekomandimit nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, i dorëzohet për shqyrtim dhe aprovim udhëheqësit më të lartë administrativ, i cili nxjerr vendim për këtë çështje.

3. Vendimi i udhëheqësit më të lartë administrativ i dërgohet për njoftim menaxherit të personelit, për veprim të mëtutjeshëm

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

39. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.

40. Përkritazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.nr.68/2022] e 28 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

41. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nën rregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.

42. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërliken me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KIO4/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

43. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nën kriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të

Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GjEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës*, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës *KI166/20*, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime "konfuzë dhe të paqarta" (shih, rastet e GjEDNJ-së, *Kemmache kundër Francës*, nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), *Juta Mentzen kundër Lituaniës*, nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).

44. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin *KI04/21*, cituar më lart, paragrafi 28).
45. Rrethanat e rastit konkret, rezultojnë nga kërkesa e parashtruesit të kërkesës për rikthim në vendin e tij të punës në Komunën e Prishtinës. Parashtruesi i kërkesës ishte punëtor i Komunës së Prishtinës përkatësisht kishte punuar në Drejtorinë për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Më 23 shtator 2011 parashtruesi i kërkesës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ishte emëruar kryesues në BPR me mandat 2 vjeçar, ku në vitin 2013 i ishte vazhduar mandati deri më 31 dhjetor 2014. Më 30 janar 2015, pasi që kishte dorëzuar mandatin e kryesuesit të BPR-së, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar me një shkresë Drejtorit të DUNMM në Komunën e Prishtinës, të cilin e kishte njoftuar për përfundimin e mandatit të kryesuesit të Bordit, dhe kthimin e tij në vendin e punës në Komunën e Prishtinës. Drejtori i DUNMM në Komunën e Prishtinës kishte përgatitur një raport për shkelje disiplinore, përmes të cilit ishte kërkuar që ndaj parashtruesit të kërkesës të merren masa disiplinore. Komisioni disiplinor i Komunës së Prishtinës kishte gjete përgjegjës parashtruesin e kërkesës. Më tej parashtruesi i kërkesës ishte ankuar në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të Komunës së Prishtinës, ku ky i fundit e kishte refuzuar ankesën e tij. Parashtruesi i ankesës kishte paraqitur ankesë në KPMSHCK, ku ishte refuzuar ankesa e tij dhe vendimi i komisionit të ankesave kishte mbetur në fuqi. Parashtruesi i kërkesës kishte filluar një procedurë gjyqësore, ku kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore ku kishte kërkuar anulimin e vendimit të KPMSHCK-së, dhe kthimin e tij në vendin e punës. Gjykata Themelore kishte aprovuar padinë e parashtruesit të kërkesës dhe kishte anuluar vendimin e KPMSHCK-së. KPMSHCK kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër vendimit të Gjykatës Themelore, të cilën ankesë Gjykata e Apelit e kishte aprovuar, ku kishte anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje. Gjykata Themelore në rivendosje prapë kishte vendosur në favor të parashtruesit të kërkesës duke e aprovuar kërkesëpadinë e tij dhe duke anuluar vendimin e KPMSHCK-së. Kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore kishte parashtruar ankesë Komuna e Prishtinës në Gjykatën e Apelit, ku kjo e fundit e kishte

aprovuar ankesën e saj dhe kishte ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke e refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pa bazuar. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, ku kjo e fundit e kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.

46. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
47. Gjykata verën se esenca e pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, ndërlihet me mos arsyetimin e vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme. Gjykata vlerëson se pretendimet e tilla ngrejne çështje nga neni 31 i Kushtetues dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, të cilat Gjykata do t'i analizojë në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.
48. Gjykata fillimisht do trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, lidhur me mos arsyetimin e vendimit nga Gjykata Supreme, duke vazhduar më pas me pretendimin lidhur me shkeljen e nenit 24 dhe 49 të Kushtetutës.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

(i) Sa i përket pretendimit për vendim të pa arsyetuar gjyqësor

49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pranë Gjykatës, në esencë, thekson se pavarësisht se me ligj është e lejuar ngrirja e pozitës, në rast të zgjedhjes në ndonjë bord të caktuar, ndaj tij janë marrë masa disiplinore për shkak të mos paraqitjes në punë në Komunën e Prishtinës. Pra parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë faktet dhe provat të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit, pasi që “...është shkelur neni 89 i Ligjit për Shërbyesit Civil, i cili garanton kthimin në vendin e punës personit i cili është transferuar përkohësisht, duke pasur parasysh se një e drejtë e tillë është e garantuar me ligj. Kësisoj Gjykata Supreme ka bërë shkelje të Kushtetutës përkatësisht të nenit 31, duke mos arsyetuar se cilat kanë qenë shkaqet të cilat kanë dërguar deri në marrjen e aktgjykimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës, konsideron se bazuar në parimet e administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të tregojnë në mënyrë adekuate arsye mbi të cilat ato bazohen në momentin e nxjerrjes së një aktgjykimi, e që aktgjykimi i kontestuar Gjykata Supreme, nuk e ka marrë fare mundin që të arsyetojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës”.
50. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë nr.12945/87*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës nr.18064/91*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër*

- Francës nr.134/1996/753/952*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës nr.30544/96*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës nr.49684/99*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës nr.37801/97*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; dhe *Tatishvili kundër Ruisë nr.1509/02*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019; si dhe rastin [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
51. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
52. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18 IF Skadeforsikring](#), të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë nr.19867/12*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego"*, Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 122).
53. Gjykata me këtë rast rikujton se Komuna e Prishtinës fillimisht, kishte njoftuar parashtruesin për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij për shkak të mos paraqitjes së tij në vendin e punës, ku më pas komisioni disiplinor e kishte shpallur përgjegjës lidhur me këto veprime. Vendimi i Komisionit Disiplinor ishte vërtetuar edhe nga Komisioni i Ankesave si dhe nga ana e KPMSHCK-së.
54. Gjykata e Apelit, duke shpallur si të bazuar ankesën e Komunës së Prishtinës, kishte ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore [A.nr.2579/2019] të 16 qershorit 2020, duke e refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, ku ndër të tjera kishte theksuar si në vijim:

“Kolegji i apelit vlerëson se pavarësisht se pala e interesuar, Komuna e Prishtinës ka iniciuar procedurë disiplinore duke i tejkaluar afatet ligjore për iniciimin e procedurës disiplinore, ky veprim i palës së interesuar ndaj paditësit,

pas kërkesës së tij të dt.02.02.2015, për kthim në punë pas mbarimit të mandatit të tij si kryesues i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, nuk i jep të drejtë paditësit të kthehet në vendin e mëparshëm të punës, ngase sipas vlerësimit të kolegjit të apelit kthimi i paditësit në vendin e mëparshëm të punës do të vinte në shprehje vetëm në rastin kur paditësi në momentin e zgjedhjes së tij nga Kuventi i Kosovës për kryesues të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, do të bënte kërkesë për pushim pa pagesë, në të cilin kërkesë do të përcaktonte qëllimin e pushimit, si dhe kohën për të cilën e kërkon pushim nga organi punëdhënës, këtu pala e interesuar, dhe se vetëm pas aprovimit të pushimit të tillë nga udhëheqësi më i lartë administrativ, atëherë do të konsiderohet pezullim i dakorduar i marrëdhënies së punës me punëdhënësin, sipas nenit 89 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 lidhur me paragrafin 2 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe vetëm në këtë rast paditësi do të mund të kthehet në vendin e mëparshëm të punës, por jo edhe siç ka vepruar në rastin konkret, pa bërë kërkesë te organi punëdhënës dhe pa aprovimin e saj nga organi punëdhënës. [...]

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, organi i paditur drejtë ka vendosur kur me vendimin e kontestuar nga paditësi nr.02/283/2015 të 22.07.2015, ka refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar duke u bazuar në nenin 89 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 15, 16 të Rregullores nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.”

55. Më tej, Gjykata Supreme në Aktgjykimin [ARJ.nr.68/2022] të 28 shtatorit 2022, ndër të tjera theksoi:

“... Kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime dhe të tjerat si në kërkesë i shqyrtoi në tërësi por i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuara ligjërisht për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykata e apelit dhe organi i paditur KPMSHCK, si në vendimin e tij me refuzimin e kërkesë padisë së paditësit, për faktin se paditësi nuk ka vepruar ligjërisht ashtu si parashihet me dispozitat e nenit 89, të Ligjit për Shërbimin Civil për pezullimin e dakorduar të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në organin punëdhënës, me rastin e përzgjedhjes përkatësisht emërimit nga Kuventi i R. Kosovës, si kryesues i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime (BPR), dhe pastaj pas mbarimit të kushtit të pezullimit të dakorduar ta ketë ruajtur të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme ose në një pozitë ekuivalente ashtu si pretendon në kërkesë dhe si parashihet në nenin 89 par.2 të këtij ligji. I njëjti nuk ka vepruar si në kuptim të nenit 16, të Rreg.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, që të bëjnë kërkesë me shkrim në organin punëdhënës për pushim pa pagesë sipas qëllimit dhe periudhën e pushimit, pastaj pas rekomandimit nga organi punëdhënës – udhëheqësi i drejtpërdrejtë kompetent, i dorëzohet për rishqyrtim dhe aprovim udhëheqësit më të lartë administrativ i cili nxjerrë vendim për këtë çështje. Sipas nenit 15 të Rregullores së njëjtë specifikohen rastet kur mund të autorizohet pushim pa pagesë për raste të veçanta nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit punëdhënës, edhe për rastet si në rastin konkret ashtu si parashihet në pikën 1.5, të këtij neni, me marrjen e detyrës së funksionarit publik, apo edhe për transferim publik të përkohshëm në detyra të tjera brenda dhe jashtë Kosovës, ashtu si pretendon paditësi, (edhe pse nuk bëhet fjalë për transferim të përkohshëm sepse këtë nuk e ka bërë organi punëdhënës), sepse po ashtu sipas pikës 1.4, të nenit 15 të kësaj Rreg. parashihet se edhe në këto raste duhet të veprohet paraprakisht njëjtë proceduralisht, ashtu që të lejohet pushimi pa pagesë, dhe pas rekomandimit dhe përfundimit të pushimit pa pagesë

nëpunësi civil e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e më parme apo ekuivalente me të, ashtu si parashihet në paragrafin 2, të këtij neni.

Në zbatim të drejtë të dispozitave të lartë cekura të Ligjit për Shërbimin Civil dhe të Rregullores 06/2011, Gjykata Supreme vlerëson se nuk ka bazë ligjore për tu justifikuar lëshimet e paditësit dhe për tu aprovuar pretendimet e tij për kthim në vendin e punës, ashtu si thekson se në listën e pagave ka figuruar me pagë zero, sepse paditësi nuk ka vepruar paraprakisht si u theksua si më lartë dhe si parashihet me dispozitat e cekura, ashtu që pas zgjidhjes së tij kryesues i BPR, të parashtrorj kërkesë për pushim pa pagesë dhe vetëm pas miratimit të pushimit të tillë nga organi punëdhënës do të konsiderohej pezullim i dakorduar i marrëdhënies së punës, ashtu si parashihet me nenin 89 të Ligjit për shërbimin civil.”

56. Gjykata vëren se fillimisht Gjykata e Apelit e më pas edhe Gjykata Supreme, duke u mbështetur në nenin 89 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 15, 16 të Rregullores nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, në esencë theksuan se parashtruesi i kërkesës nuk ka vepruar ashtu siç parashihet në dispozitat e lartcekura. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme, konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë kërkesë për pushim pa pagesë, ashtu siç kërkohet me Rregulloren nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, ku specifikohen rastet kur mund të autorizohet pushim pa pagesë për raste të veçanta nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit punëdhënës, edhe për rastet si në rastin konkret, me marrjen e detyrës së funksionarit publik.
57. Gjykata me këtë rast, rikujton se nisur nga praktika e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, e njëjta nuk kërkon përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar.
58. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë drejtuar Gjykatës Supreme, kishte theksuar se gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me vendosjen e paditësit në listën e pagave me zero nënkuptohet se ai nuk është larguar nga puna, por se ai nuk ka marrë pagë nga Komuna e Prishtinës për shkak se në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës ishte emëruar kryesues në BPR-së, dhe nga ky institucion ka marrë pagë të plotë, dhe se Gjykata e Apelit nuk e kishte marrë për bazë këtë fakt dhe se Komuna e Prishtinës nuk e ka zhvilluar në mënyrë të rregullt procedurën disiplinore ndaj tij. Të njëjtit pretendim të parashtruesit, Gjykata Supreme i ishte përgjigjur në aktgjykimin e saj, ku kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës thekson se në listën e pagave ka figuruar me pagë zero, mirëpo nuk ka vepruar sipas dispozitave ligjore, ashtu që pas zgjedhjes së tij kryesues i BPR-së, të parashtrorj kërkesë për pushim pa pagesë dhe vetëm pas miratimit të pushimit të tillë nga organi punëdhënës do konsiderohej pezullim i dakorduar i marrëdhënies së punës.
59. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimet për shkeljen e nenit 24 dhe 49 të Kushtetutës

60. Sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të vendosur mirë të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
- a) kur parashtruesi/ja thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së [*Trofimchuk kundër Ukrainës \(Vendim\) nr. 4241/03*](#), i 31 majit 2005, shih, gjithashtu, rastin [*Baillard kundër Francës \(Vendim\) nr. 6032/04*](#), i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi/ja nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij/saj (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij/saj dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, nëse autoritetet e burgut refuzojnë të paraqesin në Gjykatë dokumentet nga shkresat e lëndës së të burgosurit për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe.
61. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 dhe 49 të Kushtetutës. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatës, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese [*KI187/18 dhe KI 11/19*](#), parashtrues: Muhamet Idrizi, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73; [*KI125/19*](#) parashtrues: Ismajl Bajgora, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63; dhe së fundmi rastin [*KI175/20*](#), parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafët 79-82).
62. Thënë këtë, Gjykata konsideron se pretendimin për shkelje të neneve 24 dhe 49 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, në të vërtetë, i ka elaboruar mbi bazën e nenit 31 të Kushtetutës, duke e ndërlidhur shkeljen e këtyre të drejtave themelore, me mos arsyetimin e vendimeve gjyqësore, për çfarë Gjykata sa më sipër konstatoi se në këtë pjesë kërkesa duhet të shpallet qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme, për arsyet e lartcekura.
63. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 24 dhe 49 të Kushtetutës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi nenet e Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përfundim

64. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me mos arsyetimin e vendimit gjyqësor, që bien në fushëveprimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së dytë (ii) të pretendimeve “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, andaj të njëjtat duhet të deklarohen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.
65. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 24 dhe 49 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”.
66. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 31 gusht 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani